

VENDIM
Nr.840, datë 21.10.2010

**PËR VENDOSJEN E KABLLOS NËNDETARE NDËRKOMBËTARE ME FIBËR OPTIKE
BARI (ITALI) - GJIRI I LALZIT (SHQIPËRI), PROJEKTI “BALKANS - ITALY
NETWORK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin, në parim, të vendosjes, në ujërat tona territoriale, të kabllos nëndetare ndërkombëtare me fibër optike Bari (Itali) - Gjiri i Lalzit (Shqipëri), projekti “Balkans - Italy Network”, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Lejimin e shoqërisë UNIFI Holdings Inc. – dega Shqipëri, për të kryer studimin përkatës dhe për shtrirjen e kabllos nëndetare ndërkombëtare me fibër optike Bari (Itali) – Gjiri i Lalzit (Shqipëri).

3. Afati i kësaj leje, sipas pikës 2 të këtij vendimi, është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Autorizohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për dhënien e lejeve e të informacioneve përkatëse për pikën hyrëse, në Gjirin e Lalzit, të kabllos nëndetare ndërkombëtare sipas rregullave në fuqi.

5. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha